



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT

Nr. 4763/1 Prot.

Tiranë 01/ 8. /2017

Lënda : Kthim përgjigje,

Drejtuar: Znj. Klajda GJOSHA  
MINISTËR I INTEGRIMIT EVROPIAN

Tiranë

E nderuar Znj. Ministre,

Për sa kërkonti në Tuajën nr. 1518, dt. 11.07.2017 në lidhje me Takimin e 8<sup>te</sup> të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, Bruksel 4 Tetor 2017, bashkëlidhur po ju dërgojmë kontributin e Ministrisë së Kulturës në fushat e përgjegjësisë sonë institucionale në mbrojtje të diversitetit kulturor të minoriteteve dhe të Komunitetit Rom/Egjyptian, të përgatitur në shqip dhe anglisht.

Ndërkohë ju bëjmë me dije se përfaqësues i institucionit tonë në këtë Takim do të jetë znj. Elira KOKONA – Sekretare e Përgjithshme ([elira.kokona@kultura.gov.al](mailto:elira.kokona@kultura.gov.al)).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI

CSA – 8-th Meeting, Brussels

Oct. 4-th, 2017

Contribution of Ministry of Culture

**1. Copyright and related rights**

Albania has already approved the complete reform in regards to the copyright fulfilling and by doing so it complies with the right of the author performing within Albanian borders for Albanian authors and foreign ones.

The new law No. 35/2016 " On copyright and other related rights" is approved by the Albanian Parliament on March 31, 2016 and entered into force 6 months after publishing in the official gazette, on October 20<sup>th</sup>, 2016. The Ministry of Culture has accomplished the commitments of the Albanian government to give creators a European and competitive law on copyright.

**In respect to this law there are approved the documents and bylaws as below:.**

- Council of Ministers' Decision No. 527 dated 20/7/2016 "For the approval of the National Strategy on Intellectual Property, 2016-2020"
- Order of Ministry of Culture No. 5166 date 20/10/2016 " On defining other additional criteria and procedures for clarifying the criterias sanctioned in the article 133, as well as determining the terms and procedures for obtaining a license or renewing it, according to Article 134 of the law no. 35/2016, date 31/3/2016 "On Copyright and other related rights"
- Council of Ministers' Decision No. 33 Dt 18/1/2017 " Fee schedule approval for services by the directorate of the copyright"
- Council of Ministers' Decision No. 34 Dt 18/1/2017 " For the procedures of registration, organization and classification of the works of the copyright".
- Council of Ministers' Decision No. 35 Dt 18/1/2017 " For organizing and rewarding the National Council for Copyright "

Law 35/2016, article 31 provides for the determination by the Council of Ministers Decision of the equipment list and tools procedures related to the right of rewards, reproduction of the works of the author for private use or personal use. A draft was sent to different ministers for suggestions.

The new law on copyright provides the harmonization of legislation to the highest possible degree, between the Albanian legislation on copyright and related rights, with the *Acquis* of the European Union in its field in order to ensure the same level of protection and enforcement with those of the European Union, an obligation that derives directly from Article 73 of the Stabilization and Association Agreement.

For a wider coverage of cases involving administrative or criminal offenses, respective proposals in the Criminal Procedure Code are approved which come into force on August 1<sup>st</sup>, 2017, as well as the proposals for amending the Criminal Code have been submitted to the Ministry of Justice and are expected to be approved.

Amendments to the Code of Criminal Procedure have been an unfulfilled obligation of Chapter 7 of the National Plan for European Integration and the National Strategy of Intellectual Property 2010-2015.

On March 30, 2017 the Albanian Parliament approved the amendments proposed by the Ministry of Culture in the Criminal Procedure Code (Article 59), which address and further perfect the legal mechanisms that deal with infringement of copyright. These measures further increase the procedural efficiency in terms of sanctioning and preventing infringements in the field of copyright. There are concrete amendments on the definition of criminal offenses in Articles 148 and 149 of the Criminal Code, where they were defined as criminal offenses and the lawsuit could be filed only by the accusative injured party.

By these changes, based on Law no. 35 dated 31.03.2016 "On Copyright and Other Related Rights" may be prosecuted primarily by the proceeding bodies and legal representatives of the administration of their property rights, based on the indices for being committed a criminal offense in the field of copyright and other related rights.

The Directorate of Copyright and Related Rights is a structure within the Ministry of Culture that carries out its activity based on and for the implementation of Law no. 35/2016. This Directorate consists of two sectors, the monitoring sector and the registration-certification and complains sector.

The Copyright Directorate is dedicated to the professional growth, efficient cooperation, sharing of professional opinion as well as specialized opinions and much more efficient in its cooperation with the inspectorate and the public in cases of infringements of copyrights. It carries out new competencies for supervising the collective management organizations, cooperation with other actors and tax authorities, as well as very clearly oriented towards public awareness on copyright.

**The Directorate of Copyright and Related Rights has performed the following activities during the period 2016-2017:**

- Within the services provided by the European Commission through the TAIEX/EC Technical Assistance Program, the Ministry of Culture has been part of a workshop for the copyright in the digital world. This workshop was held on December 5-7, 2016 in Tirana with participation of Western Balkan countries.
- On 19-20 September 2016, the Interregional Conference on Collective Management of Copyright and Other Related Rights in Tirana was organized in Tirana, supported by the World Intellectual Property Organization
- In the framework of strengthening the functioning of the Collective Management Agencies, an expert mission has trained the staff of the Collective Management Agencies of Copyright and Related Rights. The training was developed by foreign experts on 28-30 September 2016. This activity was funded by the European Commission services through TAIEX / EC.
- In the framework of the World Intellectual Property Day - April 26<sup>th</sup>, competitions were held with second Primary Schools (6-9 years Schools) in order to promote creativity and innovation for new generations, and there have continued open lectures on copyrights and other related rights at the faculties of Tirana University, as well as non-public universities, too. More than 10 open lectures have been held in these Universities which will continue in other cities of the Republic of Albania. The activity was supported by the

Tirana Chamber of Commerce and Industry. Education and information for the new generation that is growing up brings down the level of piracy and infringement in a given country, a proven experience in many developed countries.

- In the framework of the cooperation that the Ministry of Culture / Directorate of Copyright and Other Related Rights has had over years with the World Intellectual Property Organization, one of the activities that was supported during 2017 by this organization, was also a National Conference on "10 years of Institution – Copyright in the Republic of Albania". This activity was organized on May 23<sup>d</sup>, 2017 in Gjirokastra.

By the new law has begun for months the supervision of collective management agencies to function and adopt their activity according to the new copyright framework. Collective management agencies, have made due revisions to their statutory acts in accordance with Law No.35 / 2016, in order to ensure a more transparent activity of their work, accountability and better remunerations distribution towards the right holders . Monitoring of the activity of these agencies is going to be done periodically from the Copyright Directorate to avoid all the issues that have been emerged and carried over years.

Another organ created by this law is National Council for Copyright, a specialized one on fee schedules. This council consists of 5 members. The council has held hearings and meetings with interested actoeer and subjects to adopt the methodology and approve the fees. The National Council for Copyright develops with professionalism and integrity its activity to conclude in an essential product in the best interest of copyright holders and users. This council during the first week of August, following a voluminous and highly professional work, in line with the experiences and recent practices of European countries, will adopt this methodology, thus setting tariffs that will be transparent, competitive for the subjects, which will directly affect the market formalizing.

By the Council of Ministers' Decision no. 36, dated 20.01.2016, it is set up State Inspectorate for Market Surveillance which will be responsible for the inspection, control and enforcement of the copyright law. This is expected to enhance the performance of market monitoring and efficiency in the fight against the informality and piracy.

## **2. On the cultural integration of minorities and Roma / Egyptian Community**

In a general analysis, in terms of improving the legal framework and policies for cultural integration and respect for the minorities' cultural rights, the Ministry of Culture is engaged in legal initiatives undertaken, such as:

- Drafting the new law "*On Cultural Heritage and Museums*", which is expected to be adopted soon, where are included legal provisions for the protection and promotion of cultural rights of minorities, too;
- Drafting the "*National Strategy for the Development of Arts, Culture and Heritage 2017-2021*", an ongoing process, which addresses issues of cultural integration of minorities;
- Likewise, the Ministry of Culture participates in the Working Group set up at the Ministry of Foreign Affairs for draft the new law "*On Minorities in the Republic of Albania*".

In this draft law, among the others, legal obligations for the preservation and promotion of cultural values of national minorities, the prohibition of discrimination on the ethnicity grounds and the strengthening of intercultural dialogue have been addressed (**Article 7 - Prohibition of discrimination**).

Meanwhile, the Ministry of Culture is studying and assessing the institutional obligations for defining and drafting sub-laws required for the implementation of the new law on national minorities.

In the by-laws in force regulating the field of cultural heritage, it is sanctioned the protection and promotion of minority cultural rights. In the Statute of the National Center for Folklore Activities (NCFA), a specialized institution answerable to Ministry of Culture, in Article 6 it is stated:

*"NCFA treats as national wealth, part of the non-material cultural heritage, all those values created by national and linguistic minorities in Albania and propagates them in the activities organized by the National Center alone or in collaboration with third parties."*

Also in the scientific-professional-artistic criterias of the participation at the annual National Folklore Festival of Gjirokastra it is stated:

*"There are to be reflected as part of the national spiritual cultural heritage, all those values created by national and linguistic minorities in Albania, reflecting and incorporating them into the programs of the districts where do they live."*

Another objective of the Ministry of Culture is to ensure greater access and active participation of minorities in cultural-artistic activities by developing and implementing projects that protect and promote their languages and cultural identities. Activities to accomplish this objective include, among the others; can be mentioned:

- Financial support from the Ministry of Culture for the cultural-artistic activities organized by minority cultural associations.
- Publication of written literature in minority language, with or without translation into Albanian.
- Increase representation of minority groups in national and international artistic festivals organized by the Ministry of Culture.
- Provision of professional assistance and advice on documentation standards on the cultural diversity and non-material heritage of minorities (trainings, workshops, etc.).

The same can be said about promoting the intercultural dialogue of the Roma / Egyptian community, too. In efforts to implement the **4<sup>th</sup> Objective of the National Action Plan for the Integration of Roma and Egyptians 2016-2020**, "*Promotion of the Roma and Egyptian identity recognition, as part of the cultural heritage of Albania*" (*Discipline Policy - Education and the promotion of intercultural dialogue*), Ministry of Culture has organized and financed numerous activities, where have performed different associations, orchestral groups and formations, representatives of the Roma / Egyptians Community.

Kontributi i Ministrisë së Kulturës

**1. E Drejta e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to**

Shqipëria tashmë ka miratuar reformën e plotë në fushën e të drejtës së autorit, duke përmbushur detyrimin për t'i dhënë mbrojtje interesave legjitime të krijimtarisë së autorëve shqiptare dhe të huaj ne vendin tonë.

Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" është miratua nga Parlamenti Shqiptar më datë 31 mars 2016 dhe ka hyrë në fuqi më datë 20 tetor 2016. Ministria e Kulturës ka realizuar angazhimet e qeverisë shqiptare për t'i dhënë krijuesve një ligj europian dhe konkurrues për të drejtën e autorit.

**Në kuadër të këtij ligji janë miratuar dokumentet dhe aktet nënligjore si më poshtë:**

- VKM Nr. 527 Dt 20/7/2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2016–2020";
- Udhëzim i MK-s Nr. 5166 Dt 20/10/2016 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr.35/2016, datë 31.3.2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to"
- VKM Nr. 33 Dt 18/01/2017 "Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit"
- VKM Nr. 34 Dt 18/01/2017 "Për procedurat e regjistrimit, të organizimit dhe klasifikimit të veprave të të drejtave të autorit"
- VKM Nr. 35 Dt 18/01/2017 "Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit " (KKDA)

Ligji 35/2016 në nenin 31, parashikon përcaktimin me Vendim të Këshillit të Ministrave të listës të pajisjeve si dhe caktimin e tarifave përkatëse në lidhje me të drejtën e shpërblimit për riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal. Aktualisht ky projektvendim është në konsultim nëpër Ministrinë e linjës për të dhënë sugjerimet e tyre.

Ligji i ri për të drejtën e autorit sjell harmonizim të legjislacionit, në shkallën më të lartë të mundshme me Direktivat e Bashkimit Evropian në këtë fushë, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e respektimit të drejtave të autorit në të njëjtin nivel, nga pikëpamja juridike, me ato të vendeve të Bashkimit Evropian, detyrim që buron drejtpërsëdrejti nga neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Për një mbulim më të gjerë dhe efikas të rasteve që përfshijnë kundërvajtje administrative apo penale janë miratuar propozimet përkatëse në Kodin e Procedurës Penale, të cilat hyjnë në fuqi në 01/08/2017 si dhe janë dërguar propozimet për amendim të Kodit Penal pranë Ministrisë të Drejtësisë dhe pritet miratimi i tyre.

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale kanë qenë një detyrim i papërbushur i kapitullit 7-të të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian dhe Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2010-2015.

Më datë 30.03.2017 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimet e Ministrisë së Kulturës në Kodin e Procedurës Penale (neni 59), të cilat adresojnë dhe përsosin më tej mekanizmat ligjorë mbi shkeljet e të drejtave të autorit. Këto masa rrisin më tej efikasitetin procedural në drejtim të sanksionimit dhe parandalimit të shkeljeve në fushën e të drejtës së autorit. Konkretisht janë parashikuar ndryshime për cilësimin e veprës penale në nenet 148 dhe 149 të Kodit Penal, ku përcaktoheshin si kundravajtje penale dhe mund të ngrihej padia vetëm nga i dëmtuari akuzues.

Me këto ndryshime tashmë, bazuar edhe në ligjin nr. 35 datë 31.03.2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”, mund të ndiqet kryesisht edhe nga organet proceduese dhe përfaqësuesve ligjorë të administrimit të të drejtave të tyre pasurore, në bazë të indicieve për konsumimin e një veprë penale në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Drejtoria e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me to është strukturuar pranë Ministrisë së Kulturës e cila ushtron veprimtarinë e saj në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 35/2016. Kjo drejtori përbëhet nga dy sektorë, sektori i monitorimit dhe sektori i regjistrim-certifikimit dhe ankimeve.

Drejtoria e të Drejtave të Autorit është një drejtori e dedikuar politikash dhe me një gamë të gjerë kompetencash në rritje të profesionalizmit, bashkëpunimit më efikas në dhënien e mendimit të specializuar dhe shumë më eficientë në bashkëpunimin e saj me inspektoratin dhe publikun në rastet e cenimit të të drejtave. Kompetenca të reja për mbikëqyrjen e agjencive dhe bashkëpunim me aktorët e tjerë dhe organeve tatimore dhe e orientuar shumë qartë drejt ndërgjegjësisimit publik të të drejtave të autorit.

**Drejtoria për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me to për periudhën 2016-2017 ka zhvilluar një sërë aktiviteteve si më poshtë:**

- Në kuadër të shërbimeve që ofron Komisioni Evropian me anë të Programit të Asistencës Teknike TAIEX/KE, në bazë dhe të aplikimeve që janë kryer, Ministria e Kulturës ka qenë përfituese por dhe njëkohësisht dhe bashkë-organizatore e workshop-it ndër-Rajonal mbi “Të drejtat e Autorit në epokën dixhitale” i cili është mbajtur më datë 5-7 Dhjetor 2016 në Tiranë me pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor
- Më datë 19-20 Shtator 2016 është organizuar në Tiranë Konferenca Ndër-rajonale mbi Menaxhimin Kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to me mbështetjen e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI)
- Në kuadër të forcimit të funksionimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv, një mision ekspertësh ka trajnuar stafin e Agjencive të Administrimit Kolektiv të të drejtës së autorit dhe të Drejtave të lidhura me to. Trajnimi është zhvilluar nga ekspertë të huaj në datat 28-30 shtator 2016. Ky aktivitet është financuar nga shërbimet e Komisionit Evropian përmes TAIEX/EC.
- Në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale – 26 Prill 2017, u zhvilluan konkurse me shkollat 9-vjeçare me qëllim nxitjen e krijimtarisë dhe të inovacionit të brezat dhe gjeneratat e reja dhe kanë vijuar leksionet e hapur për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në Fakultetet e Universitetit të Tiranës por dhe me Universitetet jo-publike. Janë zhvilluar mbi 10 leksione të hapura në këto Universitete të

cilat do të vijnë dhe në qytete të tjera të RSH. Aktiviteti u mbështet nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë. Edukimi dhe informimi për gjeneratën e re që po rritet sjell uljen e nivelit të piraterisë dhe shkeljeve në një vend të caktuar, eksperiencë kjo e provuar në shumë vende të zhvilluara.

- Në kuadër të bashkëpunimit që Ministria e Kulturës/Drejtoria për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to ndër vite ka patur me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI), një ndër aktivitetet që u mbështet gjatë 2017 nga kjo organizatë, ishte dhe një Konferencë Kombëtare mbi “10 vjet institucion - E Drejta e Autori në RSH”. Ky aktivitet u organizua më datë 23 Maj 2017 në Gjirokastrë.

Me ligjin e ri ka filluar prej muajsh mbikëqyrja e agjencive të administrimit kolektiv për të funksionuar dhe përshtatur veprimtarinë e tyre me kuadrin e ri të së drejtës së autorit. Agjencitë e administrimit kolektiv (AAK) kanë bërë rishikimet në aktet e tyre statutorë në përputhje me ligjin nr.35/2016, për të siguruar një aktivitet sa më transparent të punës së tyre, llogaridhënie dhe shpërndarje më të mirë kundrejt titullarëve të të drejtës së autorit. Monitorimi i veprimtarisë së këtyre agjencive ka filluar të bëhet në mënyrë periodike nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit për të shmangur të gjitha problematikat e shfaqura dhe mbartura ndër vite.

Një tjetër organ i krijuar nga ky ligj është Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), organ i specializuar për vendosjen e tarifave për përdorimin e veprave që mbrohen nga e drejta e autorit. Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit përbëhet nga 5 anëtarë. Ky Këshill ka zhvilluar dëgjesa dhe konsulta me të gjithë aktorët dhe subjektet e interesuar për të miratuar metodologjinë dhe masën e tarifave të shpërblimit. Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit zhvillon me profesionalizëm dhe integritet veprimtarinë e tij për të konkluduar në një produkt esencjal në interesin më të mirë të autorëve krijues dhe të përdoruesve të veprave krijuese. Ky Këshill në javën e parë të muajit gusht, pas një pune voluminoze dhe shumë profesionale, në përputhje me eksperiencat dhe praktikën e fundit të vendeve evropiane do të miratojë këtë metodologji, duke vendosur kështu tarifa të cilat do të jenë transparente, konkurruese për subjektet, çka do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në formalizimin e tregut.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 36 datë 20.01.2016 është ngritur Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut i cili do të jetë përgjegjës për inspektimin, kontrollin dhe zbatimin e ligjit për të drejtat e autorit. Kjo pritet të rrisë performancën e monitorimit të tregut dhe efikasitetin në luftën kundër informalitetit dhe piraterisë.

## **2. Mbi integrimin kulturor të minoriteteve dhe Komunitetit Rom/Egjiptian**

Përsa i përket përmirësimit të kuadrit ligjor dhe politikave për integrimin kulturor dhe respektimin e të drejtave kulturore të pakicave, Ministria e Kulturës është angazhuar në nisma ligjore të ndërmarra, si:

- Në hartimin e projektligjit “*Për Trashëgiminë Kulturore*”, miratimi i të cilit pritet së shpejti, ku janë përfshirë parashikime ligjore dhe për mbrojtjen e promovimin e të drejtave kulturore të pakicave kombëtare;
- Në hartimin e *Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Artit, Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore 2017-2021* e cila është në proces hartimi, ku trajtohen dhe çështje të integritit kulturor të pakicave kombëtare;



- Po kështu, Ministria e Kulturës ka marrë pjesë në Grupin e Punës të ngritur pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme për hartimin e projekt-ligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë projektligj, ndërmjet tjerave, janë adresuar dhe detyrimet ligjore për ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore të pakicave kombëtare, ndalimi i diskriminimit për shkak të etnisë si dhe forcimi i dialogut ndërkulturor (*Neni 7 - Ndalimi i diskriminimit*).

Ndërkohë Ministria e Kulturës po studion dhe vlerëson detyrimet institucionale për përcaktimin dhe hartimin e akteve nënligjore që kërkohen në kuadër të zbatimit të ligjit të ri për pakicat.

Në aktet nënligjore në fuqi që rregullojnë fushën e trashëgimisë kulturore, gjejnë vend dhe mbrojtja e promovimi i të drejtave kulturore të pakicave. Në Statutin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike (QKVF), një institucion i specializuar në varësi të Ministrisë së Kulturës, neni 6 thuhet:

*“QKVF e trajton si pasuri kombëtare, pjesë të trashëgimisë kulturore jo materiale shpirtërore, të gjitha ato vlera të krijuara nga pakicat kombëtare dhe linguistike në Shqipëri dhe i propagandon ato në veprimtaritë e organizuara prej saj dhe ato në bashkëpunim me të tretët.”*

Gjithashtu në kriteret shkencore-profesionale-artistike të pjesëmarrjes në Festivalin e përvitshëm Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës thuhet:

*“Të pasqyrohen si pjesë të trashëgimisë kulturore shpirtërore kombëtare, të gjitha ato vlera të krijuara nga pakicat kombëtare dhe linguistike në Shqipëri duke i pasqyruar dhe përfshirë në programet e qarqeve ku ata jetojnë.”*

Një objektiv tjetër i Ministrisë së Kulturës është sigurimi i një aksesimi më të lartë dhe pjesëmarrje aktive të pakicave në aktivitetet kulturore-artistike duke zhvilluar dhe zbatuar projekte që mbrojnë dhe promovojnë gjuhët dhe identitetin e tyre kulturor. Aktivitetet në përmbushje të këtij objekti, ndërmjet tjerave mund të përmendim:

- Mbështetja financiare nga Ministria e Kulturës të aktiviteteve kulturore-artistike të organizuara nga shoqatat kulturore të pakicave.
- Publikimi i literaturës së shkruar në gjuhën e pakicave, me ose pa përkthim në gjuhën shqipe.
- Rritja e përfaqësimit të grupeve nga pakicat në festivalet artistike kombëtare e ndërkombëtare të organizuara nga Ministria e Kulturës.
- Dhënia e asistencës profesionale dhe këshillimit për standardet e dokumentimit të diversitetit dhe trashëgimisë jomateriale të pakicave (trajnime, workshope, etj.).

E njëjta gjë mund të thuhet dhe për promovimin e dialogut ndërkulturor të komunitetit Rom / Egjiptian. Në zbatim të Objektivit të 4<sup>t</sup> (*Fusha e Politikës – Arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor*) të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, “Promovimi i njohjes së identitetit Rom dhe Egjiptian, si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë”, Ministria e Kulturës ka organizuar dhe financuar shumë aktivitete, ku kanë marrë pjesë shoqata, grupe e formacione orkestrale të ndryshme, përfaqësuesë të komunitetit rom / egjiptian.